

VENDIM
Nr. 428, datë 17.5.2017

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 592, DATË 5.9.2007, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E PERSONALITETEVE TË TJERA TË LARTA
SHTETËRORE TË VENDIT, QË DO TË RUHEN DHE MBROHEN NGA GARDA E
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË EDHE PAS LIRIMIT NGA FUNKSIONI”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 8869, datë 22.5.2003, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 2 e vendimit nr. 592, datë 5.9.2007, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë:
“2. Personalitetet e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, ruhen dhe mbrohen me oficer e nënoficer shoqërues edhe 2 (dy) vjet pas lirimit nga funksioni.”.
 2. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe Garda e Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi